



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

### EKSTRAKT

**nga Procesverbali i mbajtur më 26 qershor 2019, në mbledhjen e XIV-të (katërmbëdhjetë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.20’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fitim Haziri, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica dhe Floretë Zejnullahu, përveç anëtares Fatlume Jaha e cila mungoi,

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin Agim Blakçori Drejtor i Drejtorisë së Arsimit - DKA, Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, Donika Sfishta Drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit – DKRS, Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, Durim Salihu Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit - DI, Mirsad Kamerolli Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, Zaim Thaqi Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, Gëzim Namani Drejtor i Drejtorisë së Administratës – DA.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësuesi i OSBE-së z.Veton Vehapi, si dhe përfaqësuesi i Rrjetit të OJQ-ve, Rexhep Zeka.

### Rendi i ditës

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit, i njoftoj rreth pikave të paraqitura në këtë rend të ditës, shtoi, thirrjen materialin përkatës për këtë mbledhje e keni marrë të gjithë me kohë, andaj mund të vazhdojmë me punë.

**z.Rafet Llapashtica,** theksoi, në mbledhjen e kaluar ka mbet që në këtë seancë të silllet për shqyrtim Rregullorja për bashkëpunim me fshatra, vendbanime dhe lagje të qytetit, pasi që dëgjimi publik ka përfunduar, ka mbet vetë të jelet në Kuvendi për miratim dhe të vazhdohet me implementimin e saj përkatësisht konsolidimin sipas legjislacionit dhe udhëzimeve përkatës, natyrisht komitete dhe kryetar të fshatrave jashtë përbërjes politike, cilado qofshin ato. Duke qen në dijeni që po kemi të vështirë ta fusim në rend dite dhe po besoj që nuk është përgatit materiali, mirëpo do të kishte qenë mirë të sjellët në muajin korrik pasi tani është edhe koha e pushimeve. E them këtë sepse si Komunë e kemi edhe obligim miratimin e Rregullores në fjalë dhe implementimin e saj në mënyrë që të përfundoj procesi zgjedhor nëpër fshatra dhe lokalitete urbane. Pra unë vetëm dua të shtroj si kërkesë për seancën tjetër sepse tani sigurisht që as materiali nuk është i gatshëm edhe pse saktësisht nuk po e di cilët prej drejtorëve kanë qenë në proces, qysh ka përfundua, a ka pas plotësim ndryshim ndonjë gjë gjatë diskutimit dhe debatit publik ngase ne i kemi vetëm draftin e parë, para se të del në dëgjime publike.

Pra për këtë seancë nuk e them që të futet në rend të ditës ngase nuk kemi materiale qoftë të gjendje paraprake qoftë pas procesit të diskutimit dhe debatit publike, mirëpo për seancën e ardhshme të shikojmë deri ku ka shkuar apo ku ka ngec implementimi i vendimit që është marrë për këtë draft.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues,** konsideroj se pyetja e paraflësës është me vend dhe bëhet fjalë për një rregullore për të cilën vazhdimisht kemi pas kërkesa të nxjerrët, unë jam interesuar që të sjellët sa më shpejt në Kuvend dhe zyrtarët që kanë punuar në atë rregullore më kanë informuar që është në përfundim e sipër një draft rregullore nga ana e nivelit qendrorë në mënyrë që të bëhet një rregullore unike për të gjitha Komunitat, si dhe po ashtu sa jam në dijeni kemi në procedurë të plotësimit ndryshimit akti nën ligjor dhe shumë shpejt pritet të nxjerrët, pastaj do të bëhen harmonizimet e nevojshme dhe shpresoj që shumë shpejt do të sjellët për shqyrtim final në Kuvend

*Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar.*

## **1. Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura më 29 maj 2019**

*Njëzëri, pa vërejtje apo plotësime ndryshime u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 29 maj 2019.*

## **2. Korniza Afatmesme Buxhetore – KAB 2020/2022 e Komunitës së Podujevës**

**z.Isuf Latifi,** Drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore 2020-2022 është hartuar duke u bazuar në Qarkoren Buxhetore 2020/01 të dërguar nga Ministria e Financave me datën 15.05.2019. Me të marrë këtë Qarkore, Kryetari i Komunitës ka thirrë takim me Drejtorët e Drejtorive ku e kemi shqyrtuar dhe në bazë të kësaj kemi filluar përgatitjet për hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2020-2022. Janë mbajtur takime të brendshme për konsultim me gjithë drejtorët dhe stafin tjetër duke paraqitur kërkesat e tyre për projekte për tri vitet e ardhshme dhe në kuadër të kësaj me të përfunduar konsultimet e brendshme është mbajtur edhe një dëgjim publik me qytetarët e Komunitës së Podujevës, dëgjim i cili është mbajtur në këtë sallë të Kuvendit dhe nga i cili janë marrë kërkesat e qytetarëve dhe janë shqyrtuar në bazë të prioritetëve ku shumë prej tyre janë të inkuorpuar edhe në këtë dokument.

Po ashtu, ky dokument është i bazuar kryesisht në Qarkoren 2020/01, por që si zakonisht në të ardhme do të kemi edhe Qarkoren 2020/02 apo eventualisht e dhe 2020/03 në bazë të cilave do të përgatitet buxheti final i Komunitës së Podujevës për vitin 2020 dhe prioritetet për dy vitet e ardhshme.

Ky dokument përfshin një buxhet fillestar me të cilin kemi paraqitur kërkesat tona pa pas kufizime nëpër kategori ekonomike për arsyeje se Qarkorja e parë nuk e parashihet buxhetin të ndarë nëpër kategori ekonomike por lejon organizatat e ndryshme buxhetore të jenë të lira sa i përket planifikimeve ashtu siç mendojnë se është më së miri, ndërsa Qarkorja finale që nxjerrët në të ardhmen përkufizon kufijtë buxhetorë nëpër kategori ekonomike e që mund të ndodhë të ketë ndryshime por që ne jemi munduar të planifikojmë ashtu që ndryshimet të mos ketë ndryshime të mëdha ose mos të reflektojnë shumë në ndryshimin e kësaj Kornize Afatmesme, por të jenë përafërsisht të ngjashme me këto me ndonjë ndryshim nëpër kategoritë ekonomike në bazë të kufijve final. Pra kjo është ajo që desha të them në pika të ndryshme ngase të dhënat tjera janë të përshkruara në dokument, andaj nuk dëshiroj të ndalem në detaje sepse besoj që të gjithë e kanë shikuar dhe analizuar dokumentin në fjalë.

**z.Avni Fetahu,** theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, Kornizën afatmesme Buxhetore 2020/2022 e rekomandon për shqyrtim në Kuvendin e Komunitës.

**znj. Adelina Stublla**, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e rekomandojmë për Kuvend ku të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet tona do i cekim në seancën e Kuvendit.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, si pikë të rendit të ditës, ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së e rekomandojmë për shqyrtim në Kuvendin.

**z. Mehmet Gashi**, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së e patoi fjalën z. Avni Fetahu, por unë kam evidentuar disa gabime të cilat mund të them se janë më shumë teknike por që kanë domethënie, andaj do të ishte mirë të korrigjohen para se dokumenti të miratohet. Në faqen 21 të KAB, e kam vërejt se janë bartë shifrat e projekteve krejt, ndërsa dy rubrikat e projekteve kanë mbet të zbrazëta, andaj do të ishte mirë të përmirësohet, pastaj po ashtu në faqe 21, projekti numër 2, shuma që duhet me qenë është e projektit tjetër, pra sa kam kuptuar janë ngatërruar shumat në projekte.

*Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me korrigjimin e gabimit teknik, përkatësisht plotësim – ndryshimin në faqe 21 të KAB 2020/22 të përshkrimi i projekteve prioritare për vitin 2020 – Drejtorja e Urbanizmit, projekti me numër rendor 2 të plotësohet me shumat financiare si vijon;*

*-Emërimi i projektit – (Ndërtimi, rregullimi, riparimi dhe mirëmbajtja e shtratit të lumit Llap si dhe hapësirave përgjatë brigjeve të tij në qytet - vazhdim)''*

*-Granti 50,000, Të hyrat vetanake 10,000, totali 60,000.*

### **3. Propozim vendimi për vënie diskutim publik propozim Rregulloren për Orarin e punës për bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.**

**z. Mirsad Kamerolli**, Drejtor i DPZHE, kemi të bëjmë me këtë propozim rregullore e cila është hartuar dhe përgatitur pas kërkesave edhe nevojave të sektorit të bizneseve në Komunën e Podujevës për caktimin e orarit të punës duke përfshirë edhe një ditë të lirë gjatë javës. Kemi menduar që pasi ta diskutojmë në Kuvend, e njëjta të vëhet në diskutim dhe debat publik që planifikojmë ta mbajmë gjatë muajit korrik bashkërisht me grupe të interesit, biznese të caktuara edhe me Drejtorin e Inspeksionit e cila do të jetë kujdestare e mbarëvajtjes dhe implementimit të kësaj Rregulloreje, pra do të bisedojmë me të gjitha grupet e interesit që t'i marrim modalitetet dhe propozimet më të mira që ju hyjnë atyre në shërbime si biznese. Secilën vërejtje, propozim, sugjerim apo dhe kërkesë që do të paraqitet do ta shqyrtojmë dhe do ta inkorporojmë gjatë procesit të diskutimit dhe debatit publik, pastaj do ta sjellim për miratim final në Kuvendin e Komunës. Unë besoj që ka ende shumë çështje që do të rrjedhin prej diskutimit publik mirëpo baza fillestare është e mirë, është në interes të bizneseve edhe në interes të punëtorëve. Po ashtu sigurisht që edhe në seancën e Kuvendit do të ketë diskutime nga ana e këshilltarëve të Kuvendit të cilët e kanë rolin e vet këshillëdhënës dhe besoj do të jenë në interes të biznesit dhe punëtorëve.

**z. Fatmir Gashi, Kryesues**, theksoi, falënderoj të gjithë akterët për iniciativën e marrë dhe punën e bërë rreth kësaj rregulloreje e cila besoj që do të finalizohet qysh është më së miri.

**z. Avni Fetahu**, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LDK-së i rekomandon Kuvendit për shqyrtim dhe miratim që drafti i Rregullores në fjalë t'i nënshtrohet diskutimit dhe debatit publik, dhe natyrisht e përkrahim si iniciativë.

**znj. Adelina Stublla**, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, edhe ne si subjekt i PDK-së e përkrahim dhe e rekomandojmë për Kuvend. Besoj që është e nevojshme të ekzistoj një rregullore e tillë si dhe besoj që Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik sigurisht ka pasë komunikime me bizneset dhe akterët tjerë

relevant, nëse është kërkesë e tyre ne e mbështesim që kjo rregullore të jetë në debat publik të diskutohet edhe të dëgjohen interesat e afaristëve, do të thotë t'ju jepet hapësirë edhe atyre gjithnjë konform legjislacionit. Ndoshta drejtori në fjalë e din më mirë, por sa jam në dijeni unë ekziston edhe shoqata e bizneseve këtu në Podujevë, andaj do të ishte mirë të mbahen takime me atë shoqatë, pastaj edhe me afarist direkt dhe akter tjerë në mënyrë që të unifikohet një orar sa më i përshtatshëm për afaristët e që rrjedhimisht në një formë do të kenë fatin të përfitojnë edhe punëtorët që punojnë në sektorin privat që ta kenë mbështetjen që mos t'iu nënshtrohen vetëm bizneseve ashtu qysh ju konvenon atyre por të bëhet një harmonizimi gjithnjë me këshilla, sugjerime dhe plotësim të kërkesave, kurse pas sjelljes sërish në Kuvend, mendoj që të gjitha subjektet përfaqësuese do të kemi mundësi dhe duhet të japim kontributet, në kuadër të ligjit, për sektorin privat edhe që Rregullorja të jetë sa më unifikuere.

Pra ne i japim mbështetje për vazhdimin e procedurave.

**z.Durim Salihu**, Drejtor i DI, dëshiroj të ndërlihem vetëm sa i përket kohëzgjatjes së diskutimit publik dhe mbajtjes së debatit publik, përkatësisht kohëzgjatja do të ishte mirë të jetë 30 ditë, nga 01 korrik 2019 deri më 31 korrik 2019, kurse debati publik me qytetarë të mbahet më 15 korrik 2019 në ora 10:00, pa përjashtuar edhe konsultime tjera me grupe dhe akterë tjerë që Drejtoria mund t'i zhvilloj rreth kësaj Rregulloreje.

**z.Fitim Haziri**, shtroj pyetje se a ka pas Komuna e Podujevës më parë rregullore të tillë.

**z.Mirsad Kamerolli**, Drejtor i DPZHE, përgjigje parafolësit, po Komuna e Podujevës ka pas më parë Rregullore të tillë por që tani kemi ndryshim plotësim të legjislacionit dhe natyrisht që duhet të nxjerrët një akt i tillë në harmoni me legjislacionin në fuqi, kurse me miratimin dhe hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, ajo që ka qenë më parë do të hedhet poshtë edhe pse në një formë mund të them se është e shfuqizuar ngase nuk është e harmonizuar.

**z.Fitim Haziri**, propozoi që të ketë diskutime dhe debate me sektorë të veçantë të bizneseve.

**z.Mirsad Kamerolli**, Drejtor i DPZHE, theksoi, fusha e shërbimeve të bizneseve është e gjerë dhe secila i ka specifikat e veta, andaj edhe ne do të përpiqemi që të diskutojmë me secilin prej tyre në mënyrë që të marrim propozimet, idetë dhe sugjerimet e tyre dhe pastaj të mundohemi t'i harmonizojmë dhe t'i inkorporojmë kërkesat e tyre në dokumentin final.

*Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me propozim që, diskutimi publik të zgjat 30 ditë përkatësisht prej nga 01.07. 2019 deri më 31.07.2019, dhe debati publik me qytetarë mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës më 15.07.2019 në orën 10:00.*

#### **4. Informatë e Drejtorisë së Arsimit – Organizimi i garave në Komunën e Podujevës në kuadër të Programit Nacional për Rini**

**z.Agim Blakçori**, Drejtor i DKA-së, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, siç edhe e dini Komuna e Podujevës është pjesë e Programit Nacional për Rini të cilën e organizon Koordinatori Nacional për Kulturë Rini dhe Sport, dhe pas marrjes së vendimit nga Kryeministri i Kosovës dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes Koordinatorit Nacional dhe Kryetarit të Komunës së Podujevës **z.Agim Veliu**. Gjatë muajit shkurt dhe mars në bazë të aktiviteteve të planifikuara për realizimin e këtij plani koordinatori nacional në bashkëpunim me Drejtoritë komunale të arsimit kanë zhvilluar garat në aktivitete kulturor dhe mendim kritik, gara këto të zhvilluara në nivel shkolle ku detyrat dhe përgjegjësit e secilës palë janë të specifikuara në Marrëveshjen e Bashkëpunimit. Kanë qenë të përfshira të gjitha shkollat dhe të gjithë nxënësit nëpër kategori të ndara që janë të parapara me plan.

Gjatë muajit prill si Drejtori kemi mbajtur garën në fjalë, ka qenë i formuar një panel profesional për të bërë vlerësimin e punimeve të nxënësve të cilët janë zgjedh fitues në nivel shkollash pra dhe ka vazhdua

gara në nivel komunal. Për organizimin e tyre kemi marrë fjalë të mira edhe nga organizatorët zyra e koordinatorit nacional i cili e ka shprehë edhe publikisht, kurse me 22 qershor është organizuar gara në nivel Republike, gara për aktivitet kulturor dhe mendim kritik, pastaj nxënësit e shkollave të Komunës së Podujevës të cilët kanë dalë fitues në nivel komunal i janë përgjigjur ftesës dhe kanë marrë pjesë në gara dhe tash pritët vlerësimi nga paneli i cili është i përzgjedhur nga koordinatori nacional.

Kategori tjetër e cila është planifikuar të mbahet në kuadër të këtij programi nacional për rini kanë qenë edhe garat e diturisë, ku ne si Drejtori i Arsimit i kemi bërë të gjitha përgatitjet me kohë, jemi takuar edhe me Zyrën e Koordinatorit Nacional për të biseduar për detyrat dhe përgjegjësit të cilat burojnë nga Marrëveshja e Bashkëpunimit dhe Udhëzuesi i miratuar nga Koordinatori, për realizimin e këtyre garave, që kanë qenë të planifikuara të realizohen më datën 11 maj 2019 ditë e shtunë. Ne në bashkëpunim me të gjithë Drejtorët e shkollave dhe me mësimdhënësit, përkundër faktit që ka qenë edhe ditë vikendi, dhe për organizimin e tyre kemi ndërmarr të gjitha veprimet dhe janë bërë të gjitha organizimet, janë përgjigjur edhe nxënësit edhe mësimdhënësit, mirëpo diçka nuk ka funksionuar tek Koordinatori nacional dhe tekstet nuk janë sjell në shkolla edhe përkundër faktit që i kemi pritë me orë të tëra. Unë personalisht me stafin e Drejtorisë së Arsimit kemi qenë të organizuar dhe kemi qëndruar zyrë që prej para orës 9:00 ku kemi pritur të na sjellin informatat se çfarë po ndodhë, por nuk kemi pas asnjë informatë se çfarë është duke ndodhur, pse nuk janë sjell testet etj, dhe si pasoj e mos sjelljes së testeve, me keqardhje ju informoj edhe juve nuk është mbajtur fare gara e diturisë.

Ditën e nesërme nga zyra e Koordinatorit Nacional ka qenë këshilltari i koordinatorit dhe ka kërkuar falje në mënyrë interne, jo publikisht, në zyrën time për disa gabime që i ka pasë në realizim e tyre, mirëpo ajo çka dua të ju siguroj juve është se Drejtoria e Arsimit bashkë me të gjithë Drejtorët e shkollave i kanë marrë të gjitha masat dhe i kanë përfunduar të gjitha punët që i kanë pas në përgjegjësi dhe ndjejmë keqardhje që nxënësit e Komunës tonë nuk kanë marrë pjesë në test, por ja që kanë ndodh këto probleme dhe kjo garë nuk është zhvilluar në komunën tonë.

**z.Avni Fetahu**, theksoi, e falënderojmë drejtorin e Drejtorisë së Arsimit që ju ka përgjigj kërkesës për dhënien e një informate përmbajtësore lidhur me garën e diturisë për nxënësit e shkollave të Komunës së Podujevës. Mua më intereson të dijë më shumë rreth procedurave të mëtejshme të kualifikimit, nëse nuk është mbajtur testi qysh do të kualifikohen ata nxënës dhe a do t'ju krijohet ndonjë penges atyre nxënësve.

**z.Agim Blakçori**, Drejtor i DKA-së, përgjigje në pyetjen e parafolësit, shtoi, nuk paraqet ndonjë pengesë ngase ka qenë kategori tjetër kjo, kanë marrë pjesë në kuadër të garave në kreativitet kulturor dhe mendim kritik që janë mbajtur në kategorinë e parë, janë mbajtur në nivel shkolle dhe në nivel komunal.

**z.Fitim Haziri**, pyetje për Drejtorin parafolës, meqë atë ditë paske qenë prezent në zyrë, a keni kontaktuar me zyrën e koordinatorit nacional të cilët është dashtë t'i sjellin testet.

**z.Agim Blakçori**, Drejtor i DKA-së, përgjigje parafolësit, po kemi pas numër të kontaktit dhe kemi provuar t'i kontaktojmë, por nuk na janë përgjigj në telefonata. Ne kemi caktuar një koordinator në nivel komunal që të merret me këtë çështje që është zyrtar i Drejtorisë së Arsimit dhe i cili ka qenë i kyçur drejtpërdrejt me zyrtarët e këtij programi.

**z.Fitim Haziri**, theksoi, në bazë të asaj që ne kemi dëgjuar në rrjetet sociale që dikush e ka postuar, kanë thënë që testet i kanë sjellë. Pastaj nuk po e kuptoj se qysh Ministria e Kulturës po organizon gara për arsim.

**z.Agim Blakçori**, Drejtor i DKA-së, ka pas polemika të ndryshme, ne kemi qenë të kujdesshëm nuk kemi deshtë që ta politizojmë këtë proces, kemi qenë të matur edhe në deklaratimet tona publike me qëllim që ne kur kemi hy në këtë projekt ka qenë projekt jo politik dhe kemi shpresuar që nuk do të ketë kahje politike dhe do të jetë vetëm ana përmbajtësore dhe në të mirën e nxënësve, kështu kemi besuar dhe kështu kanë qenë edhe udhëzimet paraprake, dhe për këtë kemi hy edhe në këtë projekt që kanë hyrë

të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës. Është e vërtetë se ka pas debate se kush është dashtë me organizuar këtë garë Ministria e Arsimit apo Ministria e Kulturës, por që kemi një situatë të tillë.

**znj. Adelina Stublla**, theksoi, pyetje Drejtorit, a jeni në dijeni për çfarë arsye ka ndodh kjo që e thoni.

**z. Agim Blakçori**, Drejtor i DKA-së, përgjigje, arsyeja pse nuk ka ndodh të mbahet gara e diturisë në Komunën e Podujevës, sipas atyre është thënë që për çështje organizative s'kemi mund t'i sjellim me kohë testet për shkak të vëllimit të madh të punëve, pra kjo ka qenë arsyeja e tyre, e kanë pranuar fajësinë, edhe pse publikisht nuk kanë kërkuar falje për këtë çështje por megjithatë në të gjitha takimet që janë zhvilluar ne kemi sqaruar se ajo çka ka qenë punë e jona ne e kemi realizuar në përpikëri.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, në seancën e kaluar këshilltari z. Fatmir Rudari ka kërkuar këtë informatë dhe tani Drejtori na njoftoj që testi/gara e diturisë nuk është mbajtur fare edhe përkundër faktit që nxënësit dhe mësimmshënësist dhe gjithë safi tjetër i janë përgjigj, gjë kjo e cila është një e mirë që Komuna por edhe stafi dhe nxënësit kanë dhënë gatishmërinë e vetë. I gëzohem faktit që para kësaj në një garë tjetër Komuna e Podujevës u rëndit e para. Pavarësisht kur je i varur nga niveli qendror, kushdo qoftë ai që e ka për obligim, të sanksionon, faktikisht efekti i njerëzve është te Drejtori përse nuk është mbajtur por që përgjegjësia mbetet e Ministrisë që ka organizuar, përkundër që disponimi ka qenë që nxënësve t'ju jepet mundësia për këtë aktivitet, e që mendoj se kemi shumë talent të fushave të ndryshme që kanë marrë pjesë në gara dhe që është mirë të përkrahen. Përndryshe rreth asaj që Drejtori e tha se ajo zyrë ka kërkuar falje interne, ngase mendoj se publikisht nuk e bënë sepse sanksionohet pastaj, por kështu në atë formë e thotë, më fal se nuk ti am sjellë testet dhe shkon në Prishtinë, mirëpo si do që të jetë ne u njoftuam me situatën, ndoshta do të kishte qenë mirë që drejtori të njoftohej më përpara në mënyrë që të mos dalin fare nxënësit dhe mësimmshënësist në shkolla atë ditë dhe të presin me orë të tëra, mirëpo ne vetëm mund të diskutojmë por jo edhe të bëjmë ndonjë gjë sepse ajo ka kaluar tash më.

**z. Fatmir Gashi, Kryesues**, theksoi, nga diskutimi po rrjedh që herëve tjera në raste të tilla Drejtoria e Arsimit dhe Koordinatori përkatës kushdo qoftë ai që merr iniciativë për një çështje të jenë më koordinues dhe bashkëpunues për hir të nxënësve dhe stafit që në raste të tilla të mos të sillen rrugëve dhe të dalin joserioz.

**znj. Arlinda Kadriu**, theksoi, rreth garës së diturisë, përveç asaj që kanë ardh stafi dhe nxënësit nëpër shkolla, ka pas edhe një nivel të lartë të stresit tek nxënësit që askush nuk e ka pas parasysh këtë, krejt ajo çfarë është përfolur ka qenë se kanë ardh dhe janë kthyer, por që ata nxënës kanë qenë të përgatitur në aspektin emocional dhe psikik si dhe kanë pasë një strese ndërsa janë kthyer pa asgjë.

Kam pas kontakte me nxënës dhe pothuajse një pjesë e madhe e tyre më kanë thënë se gjatë gjithë natës kanë mësuar dhe janë përgatitur ndërsa me mos mbajtjen e garës të gjithë janë ndarë të zhgënjyer, pra krejt është në rregull ajo pjesa e zbulimit të talenteve dhe mendimit kritik, mirëpo mendoj që nuk ka qenë mirë e menduar qysh në fillim ngase shpesh ka pas edhe zhgënjim tek nxënësit. Shumë mirë që ka qenë një staf goxha mirë i përgatitur që kanë vlerësuar, mirëpo, shembull, në fillim tek niveli i shkollave kur është bërë vlerësimi i nxënësve, t'i thuhet një nxënësi se nuk ka talent, kur ai vetë mendon se ka talent për diçka, mendoj se është goxha punë e madhe, kështu që mendoj që prej fillimi në përgjithësi nuk qenë mirë e menduar, ndoshta ka qenë mirë të vie një ekip e profesionalizuar prej nivelit qendror dhe të bëjë vlerësimet e nxënësve.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, zakonisht ata Koordinatorët që i fitojnë edhe projektet ata vetëm për lekë punojnë, ata nuk janë burra të mirë që vinë të shikojnë një fëmijë këtu sa ka talent. Kjo madje po shihet se ato janë projekte me shifra miliona euro, që e ka ndokënd aty dhe i jepet projekti për komuna siç e kemi këtë rast apo edhe aktivitete tjera. Ne po e shohim çka po bëhet, si në këtë rast, nuk dëshiroj t'i dal në mbrojtje askujt, por rreth 34 komuna që kanë marrë pjesë në këtë proces ka qenë dashur që edhe Komuna e Podujevës ajo që ka hyrë në projeksion, mirëpo koordinatori nacional, a politikani apo OJQ-ja a kushdo qoftë ajo, që dëshiron ta tregoj veten për një punë, ka qenë mirë dhe është dashtë që testet,

përgatitjet, dhe materiali të sillej një ditë përpara ose në mbrëmje në institucion përkatës. Pra materiali ka qenë i gatshëm kurse të mos sjellët nëpër shkolla, ndërsa është përgatitur me para publike, por si duket për përfitime individuale, andaj për raste të tilla mendoj se duhet të merret secili qytetarë dhe të shikoj gjithsecili se ku dhe për çka po harxhohen mjetet, e jo shteti ose institucioni në një far forme të bëhet pronë e 20 apo 50 familjeve. Kështu që sa i që sa i përket rastit për mos sjelljen e materialit, ju garantoj që ai person e ka kryer misionin e vet, madje mund ta ketë llogaritur që edhe pa këtë Komunë, puna e vet kryhet, por po të kishte shtet siç duhet ish dashtë të jap llogari dikush, kush do çoftë ai person edhe pse nuk e di kush është koordinator nacional, e që mendoj se edhe Drejtori i DKA e ka të vështirë sepse kanë bërë eksperimente me arsimin në Kosovë, diku aplikohet modeli Danez, diku ai Amerikanë, diku Shqiptar, madje arsimin janë duke e udhëzuar e drejtuar me 100 kurrikula, module, projeksione e teste, megjithatë sa të mundemi ne si të zgjedhur që jemi e kemi për obligim për fëmijët dhe qytetarët e kësaj Komune ti japim mbështetje avancimit të arsimit, si dhe Drejtori me autoritetin e vet që ka të luaj një rol kyç sepse aty në ato shkolla mësojnë fëmijët e të gjithë neve të të gjitha partive politike dhe të qytetarëve në përgjithësi andaj edhe duhet t'i përkushtohemi arsimit.

Përndryshe sa i përket atyre mercenarëve të tillë që organizojnë gara nga niveli qendror, po tregoj që unë edhe pse jam në opozitë goxha i interesuar jam të merrem ata mercenar ngase jemi lodh me mercenar duke ndej zyrrave e duke punuar me legjislacione e me udhëzime administrative të ndryshme dhe duke bërë obligime lokale se çfarë të bëjmë ne nëpër Komuna, edhe pse e kemi të vështirë të dalim prej rrethit të atij legjislacioni apo udhëzimi administrativ sepse sanksionohemi pastaj edhe ne, përndryshe jam shumë i interesuar në çfarëdo forme të dalim të shikojmë se çfarë janë duke bërë, mirëpo pasi e kanë gjete kështu 'livadh' t'i marrin ato projekte, kurse ne pastaj nuk mund t'i implementojm ato projeksione të shteteve të tjera, kujtdo qofshin ato, ngase në Kosovë nuk mund të krijojmë kulturën e asnjë shteti, as cilësinë e arsimit, edhe pse kemi pasë profesionistë që kanë bërë projeksione të mira, madje edhe në sistemin e kaluar, ndërsa me këtë që jemi duke e bërë, a do të mund ta ndalim a jo nuk e di, por sa i përket atij drejtimi goxha i interesuar jam i nderuar drejtor dhe fare nuk do t'ju lejoja ty sa i përket aspektit të mbështetjes për çështje të arsimit, por kompetencë nuk kam, se po të kisha, të tregoj të drejtën pa i thirr të gjitha televizionet dhe të shikoja se kush është ai koordinator që i mobilizon 78 fshatra e shkolla pastaj mbi 15000 nxënës, e nuk i sjell letrat-testet, me qitë para mediave kush është dhe për çfarë arsye vepron ashtu nuk do ta lejoja. Pasta nganjëherë duhet të informohen edhe OSBE-ja edhe rrejt i OJQ-ve që po e monitorojnë punën e Kuvendit dhe KPF-së. Pra cila është përgjigja e atij koordinatori i cili nuk i sjell materialet në Komunë dhe të mundësoj zhvillimin e testit- garës së diturisë, dhe i cili e fiton atë projekt në cilëndo Ministri, çështje për të cilën mendoj se kanë qenë të pazëshme edhe Organizatat Joqeveritare por edhe Drejtoria e Arsimit, sepse gjëra të tilla duhet të dalin edhe në publik dhe të kërkohet falje fundja duke cekë edhe arsyet e mos sjelljes së testeve në shkollat e Komunës së Podujevës, pra ky është problemi e jo që nuk është mbajta gara e diturisë, mendoj unë.

**z.Isuf Latifi**, Drejtor i DBF, theksoi, po e shtroj në formë të pyetjes duke kërkuar edhe sqarim në një formë, që nga fillimi i këtij procesi unë nuk e kamë kuptuar këtë çështje dhe kamë pas dilema rreth asaj që kush e organizon edhe cili është qëllimi i kësaj gare, megjithatë në bazë të titullit, gara e diturisë për rininë, konsideroj se nxënësit e kanë kuptuar që ky është një test i obligueshëm për të gjithë, për detaje tjera ndoshta paksa edhe drejtori mund të na sqaroj.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, kjo ka qenë garë e përfitimit material të dikujt, kjo nuk është obligative as nuk ka të bëjë aspak me kurrikulen e arsimit e as të testimit, veç përfitimit individual. Unë vetëm një lutje do të kisha për drejtorin, në gara të tilla të mercenarve mos i angazho fare trupën mësimor dhe nxënësit, mos mobilizo fare. Me kurrikulën e arsimit sipas të cilës mbahen garat testuese, gara për bursa, gara për studime jashtë vendit, apo edhe garat e cilësisë të cilat i organizon Ministria e Arsimit, po duhet të angazhohemi dhe mobilizohemi të gjithë, përndryshe mercenarve që i sjellin nga Prishtina kushdo

qoftë ai i cili shikon vetëm të nxjerrë mjete dhe bënë marifete të tilla, unë nuk do të mobilizoj as nuk do të bëja thirrje mësimdhënësve dhe nxënësve, nuk po ju them të bëni siç them unë, por të paktën para mediave do të dilja dhe do ti tregoja atij personi që vetëm një herë mund të ma bësh një gjë të tillë.

**z.Agim Blakçori**, Drejtor i DKA-së, vendimi është marrë nga Kryeministri i Kosovës, është emëruar një Koordinator Nacional për Kulturë Rini dhe Sport, pa marrë parasysh kësaj nuk po dëshiroj prejardhjen politike e tij dhe nuk po dëshiroj t'i jap ngjyrimet politike këtij procesi. Ne i kemi besuar në bazë të prezantimit që na është bërë që është e dobishme për nxënësit tanë, në këtë mënyrë e kanë vlerësuar edhe komunat tjera, pastaj gabimet, lëshimet, jo profesionalizmi ato janë çështje e debatit që është duke vazhduar ende. Kështu që organizimet dhe përgatitjet e aktiviteteve të tilla kërkojnë profesionalizëm, e them këtë ngase janë edhe testet tjera që do të mbahen siç është, testi i maturës, testi i arritshmërisë për klasë të 9-ta, pastaj edhe teste tjera në nivel shkolle, dua të them se çështje të tilla kërkojnë profesionalizëm të jashtëzakonshëm. Andaj vërtetë janë çështje për debat publik, por besoj që do të gjenden zgjidhje dhe do të merren organet e caktuara qoftë nga Ministria e Arsimit qoftë të tjerë, që mos të organizohen gara pa një analizë të thuktë të kujtdo qofshin, në këtë rast të Koordinatorit nacional.

**znj.Arlinda Kadriu**, theksoi, garën e diturisë do ta arsyetoja dhe do të bëja thirrje për pjesëmarrje të gjithë nxënësit, mirëpo sa i përket zbulimit të talenteve në fusha të ndryshme, nuk di çfarë të them. Unë jam në dijeni shumë mirë se sa nxënësi është ndier keq, kur shembull, 30 nxënës kanë qenë në një klasë edhe është deshtë t'iu thuhet 'nuk ke talent' dhe duhesh të provosh në ndonjë talent tjetër, andaj vërtetë është paksa vështirë në aspektin emocional, pra mendoj se është dashtë të jetë sipas vullnetit dhe dëshirës për pjesëmarrje, e jo të jetë obligativ.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, nxirren rregullore e bëjnë shaka jo vetëm me komuna por në nivel të Kosovës. Mbledhjet apo takimet që mbahen qoftë me MASHT-in qoftë në kuadër të drejtorëve të Drejtorive komunale. Kurse ata mercenar të shkojnë ti përfundojnë punët e veta sepse nuk e kanë të përfunduar një ditë shkollë as nuk i din çështjet e arsimit. Unë e kam parasysh që ti si drejtor i DKA-së nuk ke faj sepse nuk kem mund të dalësh dhe të thoni, nuk e implementoj këtë projekt, mirëpo ka edhe mungesë i informimit të 35 këshilltarëve të Kuvendit e të cilët tani potencojnë se jo ti e ke mbajt jo ti nuk e ke mbajt garën. Nuk po dëshiroj të ju drejtohen as si pozitë as si opozitë, mirëpo në një formë ne të gjithë po e shohim se çfarë është duke ndodhur, pra aq injorant është ai koordinator, kushdo qoftë ai, sa që nuk e informon Drejtorinë e Arsimit që gara nuk do të mbahet dhe ti kërkon ta njoftoj edhe publikun, mësimdhënësit, nxënësit, për shkak se nuk mund t'jua sjellë testet, pra koordinator të tillë të cilët mund ti quaj edhe një lloj mercenari të cilin nuk e njoh dhe nuk e di se kush është por mund ta shohë edhe si armik të vendit sepse ai nuk njeh obligim për asgjë, ai e njeh obligim vetëm lekun e vet, kurse për këtë ai peron të shkoj në komunën të vet dhe në nivel qendror le të bëj çfarë të dojë por jo këtu.

*Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim.*

**Mbledhja përfundoi në orën 14:10**

**Procesverbalin e mbajti**

**Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0051575/19**

**Podujevë,**

**26 qershor 2019**

**Kryesuesi i Komitetit**

**Fatmir Gashi**